

SHOQËRIA RAJONALE
UJËSJELLËS KANALIZIME LUSHNJE

Nr. ____ Prot

Lushnje, më ____ . ____ 2023

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: Blerje Karburanti Gazoil D1 (10PPM ULSD)

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
Naftë -091340007 Karburant -09134100-8

VLERA E FONDIT LIMIT: 2 863 133 (Dymiljon e tetëqind e gjashtedhjetë e tremije e njëqind e tridhjetë e tre leke) pa TVSH vënë në dispozicion nga Buxheti i Shoqëris.

-
- I. Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar Autoriteti Kontraktor Shoqeria Rajonale Ujesjetlës Kanalizime Lushnje Sh.A ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

II. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas Shtojcës 8.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1. Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020, 2021, 2022, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së përllogaritur të kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar Nenin 44, pika 1, paragrafi b), si dhe neni 64 i Ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 (i ndryshuar) “Për Procedurat Tatimore ne Republikën e Shqipërisë”, në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklarave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” etj.

2.3. Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së përllogaritur të kontratës .

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislationit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislationit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi:Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvijën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar (lidhur me procedurën e hapur të thjeshtuar).

Kopje të vërtetuar të bilanceve, të audituara nga ekspertet kontabël të licencuar, të konfirmuara nga autoritetet përkatëset e Administratës Tatimore, të tre viteve fundit (2020, 2021, 2022) ku të pakten në dy bilancet e një pasnjeshme, nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Akt Ekspertizë e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, duhet të paraqitet nga Operatori Ekonomik vetëm në rastet kur janë në kushtet e përcaktuara nga neni 41, germa ‘c’ e ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” (indryshuar).

Argumentimi:Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr.10091 datë 5.3.2009 ”Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” i ndryshuar.

Specifikimet teknike dhe profesionale

Specifikimet teknike ,për mallrat objekt prokurimi të cilat duhet të përshkruajne minimumin ose tërësinë elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, janë hartuar në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40 , pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, :Për miratimin e rregullave të prokurimit publik , të ndryshuar , në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr 147, datë 21.03.2007 , ”për cilesin e lëndëve djegëseve, benzinit dhe diesel” dhe standarteve shtetërore në fuqi SSH EN 590 : 2013+A1:2017, Për këtë objekt prokurimi autoriteti kontraktor ka përdorur specifikimet teknike duke ju referuar standarteve kombëtare të marra nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimeve.

Funizimi me lëndë djegëse për automjete Diesel (Gazoil) duhet të ketë këto karakteristika : Diesel,(Gazoil) të jëtë sipas standartit EN 590: 2013+A1:2017

Specifikime të dhenat teknike të gazoil duhet të referohen standartit evropian (EN) të adoptuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit dhe që ka statusin e standartit shqiptar SSH EN 590:2013+A1:2017

Operatorët ekonomik janë të detyruar të paraqesin në ofertat e tyre mallrat e kërkuar sipas standartit të kërkuar si më sipër :

Kerkesat e përgjithshme të zbatueshme dhe metodat e provave.

Te dhenat teknike për karburantin të jenë sipas standarteve të përcaktuara nga Komuniteti Europian.

Shënim: Sipas ISHTI, nuk lejohet tregëtimi I gazoilit me përmbajtje sqfuri jo më të lartë se 10MG/kg, edhe për gjenator do të përdoret e njeja cilesi naftë bluediesiel

Specifikimet Teknike për karburantin Gazoil D1 (10PPM ULSD) të jenë sipas standarteve të përcaktuara nga Komuniteti Europian.

Treguesi cilësor	Njësia e matjes	Normat e lejuara		Metoda e provës
		minimale	maksimale	
Numri i cetanit ^b		51,0	-	EN ISO 5165 EN ISO 15195
Indeksi I cetanit		46,0	-	EN ISO 4264
Densiteti në 15 °C ^c	kg/m ³	820,0	845,0	EN ISO 3675 EN ISO 12185
Hidrokarburët aromatikë policiklikë ^d	% (m/m)	-	8,0	EN 12916
Përmbajtja e sqfurit ^e	mg/kg	-	deri 10,0	<u>EN ISO 13032</u> EN ISO 20846 EN ISO 20884
Pika e flakërimit	°C	mbi 55	-	EN ISO 2719
Mbetja e karbonit ^f (në 10 % mbetje distilimi)	% (m/m)	-	0,30	EN ISO 10370
Përmbajtja e hirit	% (m/m)	-	0,01	EN ISO 6245
Përmbajtja e ujit	mg/kg	-	200	EN ISO 12937
Ndotja e përgjithshme	mg/kg	-	24	EN 12662 _g
Korrozioni I shufrës së bakrit (3 orë në 50 °C)	klasifikimi	kategoria 1		EN ISO 2160
Përmbajtja e esterit të metilit të acidit yndor (FAME)	% (V/V)		7,0	EN 14078
Qëndrueshmëria ndaj oksidimit	g/m ³ ore	- 20	25	EN ISO 12205 EN ISO 15751 _i
Vetitë lubrifikuese, diametric I korrektuar I njollës së gripuar (gërryer) (ësd 1,4) në 60 °C	µm	-	460	EN ISO 12156-1
Viskozitetinë 40 °C	mm ² /s	2,00	4,50	EN ISO 3104
Distilimi ^{h, i} distilati që vlon në 250°C, % (v/v)	% (V/V) % (V/V)	85	< 65	EN ISO 3405

Adresa : Lgj.18 Tetori, Rr. Vath Korreshi, pranë ish-parkut të mallrave

E-mail : kontakt@ukl.al :

NIPT : M24606401K

distilati që vlon në 350 °C,%(v/v)	°C		360	
distilati që vlon në 95 % (v/v)				
Shënim : Kërkesat me shkronja te zeza i referohen Direktivës Europiane për lëndët Djegëse 98/70/EC {1}, duke përfshirë Amendamentin 2013/17//EC {2} dhe Amendamentin 2009/30/EC [8]				

Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

Plotësimi i kërkesave të mësipërme, përveç deklaramit nga ana e operatorit ekonomik , do të shoqërohen edhe me flet – analizën përkatse e cila do të konsiderohet e rregullt dhe e vlefshme, vetëm nëse analiza është kryer nga një laborator shtetëror apo i autorizuar i tij, dhe në përputhje me Standartin SSH EN 590:2013+A1:2017

1.1 Operatori Ekonomik duhet te jetë i paisur me certifikatën ISO 9001 : 2015 ose ekuivalente me të.

1.2 Operatori ekonomik duhet të paraqisë një vërtetim të lëshuar nga ISHTI, që subketi ofertues ka importuar dhe /ose treguar karburante sipas standardeve te legjistacionit.

Argumentimi : Ky kriter është i rëndësishëm , pasi garanton Ak-ne që Operatori Ekonomik ofertues ofron cilësinë duke respektuar standartet Ligjore si dhe respekton normat dhe të gjitha masat mbrojtëse duke ofruar furnizim cilësor si dhe operatori ekonomik ofertues zbaton kushtet e prashikuara në lejet apo autorizimet përkatëse për ushtrimin e aktivitetit.

1.3 Operator Ekonomik duhet të pajisë Autoritetin Kontraktor me sasinë e tollonave të naftës të barazvleshme me sasinë e naftës sipas Fatures origjinale të leshuar prej tij , e cila merret në dorëzim nga personi i autorizuar i AK.

1.4

Duhet te ketë stacione të tregtimit me pakicë te karburantit (me Shërbim 24 orë, cdo ditë të javës) brenda territorit të Bashkis Lushnje, të vërtetuar me një nga format e disponimit sipas Kodit Civil (kontratë noteriale qeraje , akt pronësie, të pasqyruara ne ekstratin e QKB- së)
Ofertuesi duhet te marre përsipër dhe garantojë gjithcka sa me sipër të cilesojë , vendodhjet dhe adresat e sakta të tyre, numrat e telefonit dhe person I kontaktit

Argumentimi : Operatori Ekonomik fitues duhet të ketë pika furnizimi me pakicë branda territorit të Bashkisë Lushnje , pasi Shoqëria Rajonale Ujësjelles Kanalizime Lushnje ofron shërbim vetëm brënda këtij territori dhe nuk do ishte në interesin tonë që mjetet të shkojnë të furnizohen jashtë territorit të Bashkisë, pasi pjesa më e madhe e karburantit do shkonte për transportin e mjeteve dhe jo për kryrjen e punimve të ndryshme .

Njesia e Prokurimit

Serxhjo Zylali

Ferdinant Gjermani

Denisa Sina

Adresa : Lgj.18 Tetori, Rr. Vath Korreshi, pranë ish-parkut të mallrave

E-mail : kontakt@ukl.al ;

NIPT : M24606401K